



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE



KOMISIONERI

ilirjan.celibashi@cec.gov.al
www.cec.org.al

RELACION

PËR PROJEKT RREGULLOREN E MBLEDHJEVE TË KOMISIONIT RREGULLATOR PRANË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE.

Në zbatim të nenit 15, pika 3, dhe neni 20, pika 1, germa “d” të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, është përgatitur projektregullorja “Për organizimin dhe funksionimin e mbledhjeve të Komisionit Rregullator”. Kjo rregullore hartohet në kuadër të përmbushjes së detyrave të përcaktuara në nenin 15 dhe 20 të Kodit Zgjedhor, dispozita të cilat krijojnë një arkitekturë të re të administratës zgjedhore me krijimin e 3 organeve drejtuese duke përcaktuar ndër të tjera edhe detyrën e miratimit të rregullores për organizimin e mbledhjeve të Komisionit Rregullator.

Projektregullorja e Komisionit Rregullator, përbëhet nga 36 nene, strukturuar në VI kapituj, të trajtuara si më poshtë:

Kreu I-rë përmban dispozita të përgjithshme si qëllimi, objekti, ligji dhe parimet mbi të cilat udhëhiqet vendimmarrja e Komisionit Rregullator. Në këto dispozita identifikohen marrëdhëniet e trajtuara në këtë rregullore në raport me administratën e KQZ-së dhe Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve, si dhe procedurat e vendimmarrjes së Rregullatorit. Në këtë kre parashikohet baza ligjore mbi të cilën mbështetet puna dhe veprimtaria e Rregullatorit duke patur në konsideratë hirarkinë e normave ligjore në Republikën e Shqipërisë, si Kushtetuta, Kodi Zgjedhor, Kodi i Procedurave Administrative, sipas rastit kur është e mundur Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë si edhe akteve nënligjore të miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Në një nen më vehte, konkretisht në nenin 1 të saj, projektregullorja thekson mbështetjen e veprimtarisë së Rregullatorit edhe në parime të tilla si parimet e pavarësisë, paanshmërisë, integritetit, transparencës, efikasitetit, profesionalizmi, parime të cilat karakterizojnë në mënyrë të posacme veprimtarinë e trupave zgjedhore edhe në vende të zhvilluara.

Qëllimi i kësaj rregulloreje është organizimi dhe funksionimi i punës dhe i mbledhjeve të Komisionit Rregullator (në vijim “Rregullatori”) pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave të detajuara për mbledhjet e Rregullatorit pranë KQZ, mënyrën e funksionimit të Rregullatorit dhe procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të akteve në përputhje me parashikimet e ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar .

Kreu II-të në përmbajtjen e tij ka 5 nene. Përmban dispozita në lidhje me përbërjen kompetencat të drejtat dhe detyrat e Kryetarit dhe anëtarëve të tij. Neni 3 identifikon Rregullatorin si organ drejtues të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në përputhje me parashikimet e nenit 16 të Kodit Zgjedhor.

Neni 4 qartëson kompetencat e Rregullatorit dhe të vendimmarrjes në përputhje me kompetencat e përcaktuara në nenin 20 të Kodit Zgjedhor. Të drejtat dhe detyrat e kryetarit dhe anëtarëve të Rregullatorit janë përcaktuar në nenet 5 dhe të kësaj projektregullore si dhe janë përcaktuar afatet për njohjen me rendin e ditës, materialet e mbledhjes. Neni 7 identifikon strukturën administrative përgjegjëse për asistimin e mbledhjeve të Komisionit Rregullator.

Kreu III-të përmban dispozita që normojnë marrëdhëniet e përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore/partive politike në veprimtarinë e Komisionit Rregullator.

Për shkak të implementimit të kësaj arkitekture të re të administrimit zgjedhor, ku përveç Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve kompetenca në lidhje me administrimin zgjedhor në kuadër të miratimit të politikave rregullore, ka edhe Komisioni rregullator, bëhet e domosdoshme identifikimi i marrëdhënieve që rregullohen ndërmjet përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore dhe Komisionit Rregullator.

Neni 8 përcakton detyrimet e përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore/politike për regjistrimin e tyre në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve si dhe identifikon strukturën kompetente për regjistrimin e subjekteve administratën e KQZ-së dhe detyrimin e saj për të vënë në dispozicion të Rregullatorit kopje të regjistrit të posaçëm që identifikon përfaqësuesit dhe kontaktet e subjekteve zgjedhore. Nenet 9 dhe 10 parashikojnë detyrimin e përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore të pajisen me autorizim i cili miratohet nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Kreu IV-t përmban dispozita që rregullojnë veprimtarinë vendimmarrëse të Komisionit Rregullator. Neni 11 përcakton rregullat për thirrjen, njoftimin dhe përgatitjen e mbledhjeve të Rregullatorit. Neni 12 dhe 13 përcaktojnë rregulla dhe afate procedurale për njoftimin dhe zhvillimin e mbledhjeve gjatë periudhës dhe pas periudhës zgjedhore. Neni 14 identifikon dokumentacionin e domosdoshëm që duhet të përmbajë dosja e materialeve të mbledhjes. Nenet 15 deri 19 përmbajnë procedura për administrimin, qarkullimin dhe menaxhimin e dokumentacionit të materialeve të mbledhjeve. Nenet 20 deri 26 përmbajnë rregulla për mbarëvajtjen e zhvillimit të mbledhjeve, të drejtat dhe detyrimet e palëve për tu dëgjuar në procesin administrativ si dhe rregulla për shqyrtimin e mbledhjeve të Rregullatorit.

Kreu V-të përcakton rregulla për diskutimet dhe mënyrën e votimit të akteve. Nenet 27 deri 30 përcaktojnë rregullat për hapjen e diskutimeve dhe votimin në parim, dhe kohën në dispozicion që ju jepet përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore dhe mbylljen e diskutimeve. Neni 30 dhe 31 përcaktojnë rregulla për votimin e propozimeve të projektakteve dhe votimin e tyre. Neni 32 përcakton rregulla për regjistrimin e mbledhjeve, zbardhjen e vendimit, ndërsa neni 33 dhe 34 përcaktojnë elementët e domosdoshëm për formën e aktit dhe nënshkrimin e tij.

Kreu VI-të identifikon dokumentacionin që administron administrata e KQZ-së për aktet e Komisionit Rregullator si dhe veprimtarinë që duhet të ndjekin.

Kjo projekt rregullore ka marrë në konsideratë edhe përvojën e administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të krijuar ndër vite.

**Komisioneri
Ilirjan CELIBASHI**

